

“Investment Sherko – ikub Group” shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024



PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 16



"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2024**

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	639,212	5,406,164
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	5	177,647,341	152,974,990
Te tjera llogari te arketueshme	6	2,595,285	2,645,779
Totali i aktiveve afatshkurtra		180,881,838	161,026,933
Aktivet afatgjata			
Aktive financiare	7	2,280,954	2,230,460
Totali i aktiveve afatshkurtra		2,280,954	2,230,460
Totali i aktiveve		183,162,792	163,257,393
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura	8	-	2,593,078
Detyrime tatimore	9	20,967	20,967
Te tjera detyrime	10	50,000	50,000
Totali i detyrimeve afatshkurtra		70,967	2,664,045
Detyrime afatgjata			
Totali i detyrimeve afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		70,967	2,664,045
Kapitali			
Kapitali i nenshkruar	11	2,000,000	2,000,000
Rezerva ligjore		200,000	200,000
Rezerva te tjera		129,816,125	147,286,922
Fitimi i ushtrimit		51,075,700	11,106,426
Totali i kapitalit		183,091,825	160,593,348
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		183,162,792	163,257,393

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



"Investment Sherko – ikub Group" shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	12	(40,306)	(505,560)
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(152,520)	(155,892)
2) Te tjera shpenzime	13	(152,520)	(155,892)
Shpenzime të personelit	14	(851,700)	(787,648)
1) Paga dhe shpërblime		(729,816)	(702,720)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(121,884)	(84,928)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	15	52,120,226	12,555,526
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda grupit)		52,120,226	12,555,526
Fitimi para tatimit		51,075,700	11,106,426
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	16	-	-
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	-
Fitimi i vitit		51,075,700	11,106,426
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		51,075,700	11,106,426

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2022	2,000,000	200,000	119,473,928	80,284,733	201,958,661
Fitimi / Humbja e vitit				11,106,426	11,106,426
Lëvizjet përmes kapitalit			80,284,733	(80,284,733)	-
Dividendë të paguar			(52,471,739)		(52,471,739)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2023	2,000,000	200,000	147,286,922	11,106,426	160,593,348
Fitimi / Humbja e vitit				51,075,700	51,075,700
Lëvizjet përmes kapitalit			11,106,426	(11,106,426)	-
Dividendë të paguar			(28,577,223)		(28,577,223)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2024	2,000,000	200,000	129,816,125	51,075,700	183,091,825

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 janë aprovuar nga administratori Investment Sherko – ikub Group shpk më 20 Shkurt 2025 dhe janë firmosur si më poshtë.




Migena Sherko
Administrator



"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		51,075,700	11,106,426
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzimet financiare jomonetare		40,306	502,342
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(24,621,857)	42,924,952
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(2,593,078)	(82,188)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		23,901,071	54,451,532
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e investimeve të tjera		(50,494)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(50,494)	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Dividendë të paguar		(28,577,223)	(52,471,739)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(28,577,223)	(52,471,739)
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		(4,726,646)	1,979,793
Mjetet monetare në fillim të periudhës		5,406,164	3,928,713
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		(40,306)	(502,342)
Mjetet monetare në fund të periudhës	4	639,212	5,406,164

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 16, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



1. Informacion i përgjithshëm

"Investment Sherko – ikub Group është rregjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë regjistrave të Qendrës Kombëtare të rregjistrimeve më datë 18 Janar 2012 me NIPT L21318042U. Selia e shoqërisë është në Rrugën Abdyl Frashëri, Hekla Center, Seksioni C, Kati 2, Tiranë. Kapitali i shoqërisë është 2,000,000 lekë. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është Znj. Migena Sherko.

Ortaku i vetëm i shoqërisë është Z. Romeo Sherko i cili zotëron 100% të kuotave të kapitalit.

Aktiviteti i shoqërisë është në fushën e shitjeve të licensave software dhe shërbimeve përkatëse të lidhura me to. Dhënia me qira e softwareve. Shërbime të adoptimit dhe të përshtatjes së softwareve. Shërbime supporti dhe mirëmbajtje të teknologjisë së informacionit, shërbime të konsulencës teknike në fushën e teknologjisë së informacionit dhe aktivitete të tjera të subjekteve private e publike. Shërbime trajnimi dhe edukimi në fushën e teknologjisë së informacionit etj.

Më 31 dhjetor 2024 Shoqëria kishte 1 punonjës (2023: 1 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018 datë 30 maj 2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrin nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:



2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2024 dhe 2023 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2024	2023
Euro/LEK	98.15	103.88
USD/ LEK	94.26	93.94
GBP/LEK	118.16	119.47



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përfaqësohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlërësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlëruar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlërësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlërësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlërësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlërësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlërësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlërësimi i akumuluar.

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktivitetit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivitetit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.

Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të aktiveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të aktiveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijin Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Gjatë vitit financiar aktual, kompania ndryshoi metodën e amortizimit nga metoda mbi vlerën e mbetur, në metodën lineare. Ky ndryshim është bërë për të pasqyruar më mirë modelin e përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga këto aktive.

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja fillestare e aktivit. Sipas kësaj metode, kostoja e një aktivi shpërndahet në mënyrë të barabartë gjatë jetës së tij të dobishme.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Shoqëria i njeh të ardhurat kur transmeton energjinë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetem qira operative.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.



3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t’u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t’u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2024 është 15% (2023: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar fluksin e pritshëm të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Mjete monetare në bankë	639,212	5,406,164
Llogari rrjedhëse	639,212	5,406,164
	<u>639,212</u>	<u>5,406,164</u>

5. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Dividende te arketueshem nga ikubINFO International	31,587,462	6,915,111
Dividende te arketueshem nga ikubINFO	146,059,879	146,059,879
	<u>177,647,341</u>	<u>152,974,990</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arketueshme më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Tatim fitimi	2,595,285	2,595,285
Të tjera kërkesa të arkëtueshme	-	50,494
	<u>2,595,285</u>	<u>2,645,779</u>

7. Aktive financiare

Në llogaritë e tjera të arkëtueshme paraqiten Investimet në pjesëmarrje që kompania zotëron në kompani të tjera: Aktivet financiare detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Investime ne pjesemarrje:		
ikubINFO International shpk	1,433,040	1,433,040
ikubINFO shpk	847,914	797,420
	<u>2,280,954</u>	<u>2,230,460</u>



"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

8. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura paraqiten si më poshtë më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Romeo Sherko	-	2,593,078
	<u>-</u>	<u>2,593,078</u>

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	16,961	16,961
Tatimi mbi te Ardhurat nga Punesimi	4,006	4,006
	<u>20,967</u>	<u>20,967</u>

10. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Detyrime ndaj personelit	50,000	50,000
	<u>50,000</u>	<u>50,000</u>

11. Kapitali aksionar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 2,000,000 Leke, i zotëruar 100% nga z. Romeo Sherko.

12. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga shitja e aktiveve financiare dhe nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023</u>
Fitime nga këmbimet valutore	-	-
Humbje nga këmbimet valutore	(40,306)	(505,560)
	<u>(40,306)</u>	<u>(505,560)</u>



"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

13. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Komisione bankare	31,220	33,380
Taksa te ndryshme	74,500	74,500
Shpenzime te tjera	46,800	48,012
	152,520	155,892

14. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Shpenzime për paga	729,816	702,720
Shpenzime për sigurime shoq e shend	121,884	84,928
	851,700	787,648

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2024 është 1 (2023:1).

15. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet dhe të ardhurat nga interesat dhe të ardhurat nga dividendët, që lidhen me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023
Te ardhura nga dividendet ikubINFO shpk	5,952,275	5,640,415
Te ardhura nga dividendet ikubINFO International shpk	46,167,951	6,915,111
	52,120,226	12,555,526



"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara ne FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar ne FDP e TVSH është si më poshte:

	Për vitin e mbyllur më Dhjetor 31, 2024
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	-
Shitje te dekalruar ne FDP qe jane te ardhuran ne PASH	-
Te ardhura te deklaruar ne PASH te cilat jane deklaruar shitje ne FDP	-
Të ardhura nga dividendi ikubINFO shpk	5,952,275
Të ardhura nga dividendi ikubINFO International shpk	46,167,951
Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit	52,120,226

16. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2023; 15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023:

Shoqëria ka fitim tatimor të paraqitur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2024	31 Dhjetor 2023
Fitimi para tatimit	51,075,700	11,106,426
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	46,800	48,012
Shpenzime të tjera pa dokumenta	46,800	48,012
Te ardhura te perjashtuara nga tatimi mbi fitimin	-52,120,226	-12,555,526
Te ardhura nga dividendet nga investimet ne pjesmarrije	-52,120,226	-12,555,526
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	-997,726	-1,401,088
Fitimi i tatueshem/ humbje fiskale	-997,726	-1,401,088
Shkalla tatimore e tatim fitimit	15%	15%
Tatim fitimi @15%	-	-
Fitimi/humbja e Vitit	51,075,700	11,106,426

	2024	2023
Tatim mbi fitimin		
Tatimi i parapaguar më 01.01.2024/2023	2,595,285	2,595,285
Tatimi i vitit ushtrimor	-	-
Tatimi i derdhur tepër/ (për tu paguar)	2,595,285	2,595,285



"Investment Sherko – ikub Group" shpk

(Vlerat janë në Lek)

Të ardhurat e marra nga dividendët nga Investimet ne pjesëmarrje nuk merren në konsideratë në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, sipas nenit 29 të Ligjit 29/2023 "Për Tatimin mbi të ardhurat".

Në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të një entiteti rezident, dividendët e marrë përjashtohen nga e ardhura e tatueshme në qoftë se:

a) entiteti marrës ka aksione apo pjesëmarrje prej të paktën 10%, në vlerë ose në numër në kapitalin aksionar ose të drejtat e votimit të entitetit shpërndarës; dhe

b) aksionet ose pjesëmarrja minimale janë mbajtur për një periudhë të pandërprerë prej së paku 24 muajsh.

Kjo zbatohet edhe për entitetin jorezident të tatimit mbi të ardhurat e korporatës nëse pjesëmarrja ka të bëjë me veprimtaritë e biznesit të kryera nga një jorezident në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet një entiteti të krijuar në Republikën e Shqipërisë.

17. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2024 dhe 31 dhjetor 2023 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
<u>Bilanci kontabël</u>		
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
Romeo Sherko	-	2,593,078
	<u>-</u>	<u>2,593,078</u>
	<u>31 dhjetor 2024</u>	<u>31 dhjetor 2023</u>
Të arketueshme nga palët e lidhura		
Dividende te arketueshem nga ikubINFO International	31,587,462	6,915,111
Dividende te arketueshem nga ikubINFO	146,059,879	146,059,879
	<u>177,647,341</u>	<u>152,974,990</u>

18. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

